REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORATI

Nr 415 Prot.

Gjirokastër, më 08 / 03 /2019

**Lënda:** Ngritja e grupit të punës për koordinimin e procesit në kuadër të aktiviteteve përkryerjen e Sondazhit Kombëtar të Studentëve .

**AGJENSIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

**TIRANË**

Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 5 / 57 prot , datë 01.03.2019 "Mbi zhvillimin e Sondazhit Kombëtar të Studentëve " pika 1, ju bëjmë me dije se Institucioni ynë ka ngritur grupin e punës i cili do të koordinojë procesin dhë përbëhet nga anëtarët si mëposhtë:

1. **Klaviora Dudumi** — **Përgjegjëse e sektorit të kurrikulave dhe standarteve të cilësisë**
   email : kdudumi@uogj.edu.al Tel: 0696926002
2. **Gentian Ruspi** — **Koordinator Institucional**
   email: gengjeo@yahoo.com Tel : 0697331385
3. **Alban Kllapi** — **Specialist IT - je**
   email: akllapi@uogj.edu.al Tel : 0692756265
4. **Dritan Kllapi** — **Specialist IT – je**
   dmiho@uogj.edu.al Tel:0695313959
5. Vladimir Belaj — Specialist i Kurrikulave
   email: belajladi@gmail.com Tel:0694303247

*Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,*

REKTOR

Prof. Dr Bektash MEMA

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SEKTORI I STANDARTEVE DHE I KURRIKULAVE

Gjirokastër, më 02/04/2019

# RELACION

Në zbatim të shkresës së ASCAL me nr. 5/57 prot, datë 01. 03. 2019 " Mbi zhvillimin e Sondazhit Kombëtar të Studentëve ", institucioni ynë menjëherë u vu në lëvizje dhe organizoi punen në lidhje me pikat e kërkuara në këtë shkresë. U ngrit gurpi i punës i cili do të koordinojë këtë proces dhe në datën 20 . 03. 2019 , u përmbyll faza e parë e procesit me dërgimin e të dhënave ( emër, mbiemër ,email për secilin student të institucionit tonë.) Gjatë kësaj kohe grupi i punës i ngritur nga Rektorati i përbërë nga zv/ Rektori për procesin mësimor, Koordinatori institucional, përgjegjësia e sektorit të standarteve dhe kurrikulave dhe specialistet e IT dhe përfaqësues studentor kanë zhvilluar takime informuese në lidhje me zhvillimin e sondazhit kombëtar të studentëve.

Në datën 20 Mars 2019 ka mbëritur në institucionin tonë njoftimi nga ASCAL nëpërmjet Koordinatorit Institucional mbi axhendën e takimeve të grupit të specialistëve të ASCAL në universitetin tonë. Takimet që ishin përcaktuar ishin dy me orare të ndara nga njëri tjetri. Takimi i parë do të ishte me grupin e punës dhe takimi i dytë do të ishte me studentët.

Ne si grup punë ngritëm një axhendë dhe u organizuam për të sigurar ambjentin e pjesemarrjen në këtë takim të studentëve. Kemi njoftuar instancat përkatëse si Dekanët e Njësive Kryesore, Përgjegjësat e Njësive Bazë për këtë takim në mënyrë që të merrnim masa për të siguruar sa më shumë student. Dekanatet kanë zhvilluar mbledhje ku në rend dite kishin përcaktuar edhe marrjen e masave për zhvillimin e këtij takimi .

Në datën 28. 03. 2019 ora 09.00 u zhvillua takimi i parë me grupin e punës së institucionit dhe specialistet e ASCAL. Në këtë takim u bë prezantimi i grupit dhe u prezantua projekti për Sondazhin Kombëtar të Studentëve. Në këtë takim u ra dakort që të koordinohet puna midis tre shtyllave kryesore ASCAL – IAL



REPUBLIKA E SHQIPERISE -- UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTER

- Student për të patur një përqindje të lartë të plotësimit të këtij pyetësori që do të evidentojë të mirat dhe problematikat në IAL-të publike.

Pas mbarimit të takimit të parë u zhvendosëm në sallën që ishtë vënë në dispozicion për takimin me studentët. Në këtë takim kishte studentë përqaqësues të të gjitha programeve dhe cikleve. Takimi me studentët zgjati 15 minuta dhe u prezantua projekti Sondazhi Kombëtar i Studentëve si një metodë për të nxjerrë informacione të nevojshme për funksionimin e arsimit të lartë në tërësi.

U prezantuan të gjitha hapat për plotësimin e këtij pyetësori dhe modalitetet që duhet të ndiqet nga studentët.

Grupi i punës i institucionit do të zhvillojë takime të herë pas hershme me studentët për ti orientuar herë pas herë për plotësimin e pyetësorit online dhe vënien në dispozicion të ambienteve me akses interneti të cilat janë në dispozicion të tyre.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin !

**PËRGJEGJËSE E SEKTORIT TË STANDARTEVE DHE KURRIKULAVE**

**KLAVIORA DUDUMI**

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM CABEJ" - GJIROKASTER

REPUBLIKA ESHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORATI

Nr. 582 Prot

Gjirokastër, më 09 / 04 /2019

# NJOFTIM

Njoftohen të gjithë studentët e Universitetit " Eqrem Çabej " , Gjirokastër se duke filluar nga data **16 Prill 2019 deri në 02 Maj 2019,** do të zhvillohet **Sondazhi Kombëtar i Studentëve**, i cili organizohet nga Agjensia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.

Sondazhi Kombëtar i Studentëve është një proces i cili ka si qëllim kryesor vlerësimin dhe matjen e cilësisë në arsimin e lartë duke vlerësuar performancën e IAL-ve në veprimtarinë e mësimdhënies, mësimnxënies dhe kompetencave dhe mbështetjes ndaj studentëve.

Ky sondazh është i rëndësishëm të plotësohet nga të gjithë ju dhe të shprehni mendimin e tuaj të pavarur rreth IAL-së ku keni zgjedhur të studioni.

Ky pyetësor zhvillohet online, në adresën elektronike të secilit prej jush do të dërgohet një link i personalizuar për secilin student. Pas klikimit të këtij linku do tju shfaqet pyetësori online.

Plotësimi i këtij pyetësori është **anonim** dhe bazohet tërësisht në opinionin individual të secilit prej jush.

Universiteti " Eqrem Çabej " vë në dispozicioni tuaj ambientet me akses interneti dhe bazë materiale të nevojshme (kompjutera) si mëposhtë :

1. Laboratori i Informatikës Godina B kati i III
2. Salla Multi Media Room , Godina A kati i II
3. Qendra e Këshillimit të Karrierës / ALUMNI Godina C kati i III

Këto ambiente do të jenë në dispozicionin tuaj nga ora 08.00 deri në orën 16.00 gjatë gjithë periudhës që do të zhvillohet sondazhi.

***Për çdo informacion shtesë apo paqartësi , Ju lutemi drejtohuni pranë zyrës së Standarteve dhe Kurrikulave.***

**Duke ju falenderuar !**

**REKTORATI**
**I**
**UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ "**

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" - GJIROKASTER

Rruga "Studenti" Lagjia "18 Shtatori", Gjirokaster 6001, Tel: 084263408 Web: www.uogj.edu.al ,email : rektori@uogj.edu.al

| KESHILLI STUDETOR I UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Emër Mbiemër** | **Cikli i studimit** | **Programi i studimit** | **Tel** | **Email** |
| 1. | Anxhela Late | Cikli i II i studimeve | Kontabilitet Finance | 0696958391 | anxhelalate51@gmail.com |
| 2. | Albina Meci | Cikli i I i studimeve | Biologji –Kimi | 0697723796 | mecialbina@gmail.com |
| 3. | Eri Mëhilli | Cikli i I i studimeve | Biologji – Kimi | 0697358312 | erimehilli123@gmail.com |
| 4. | Valentino Seferi | Cikli i I i studimeve | Biologji – Kimi | 0695651497 | valentinoseferi@hotmail.com |
| 5. | Irini Naçi | Cikli i I i studimeve | Kontabilitet –Financë | 0696316311 | naciirini@gmail.com |
| 6. | Melpomeni Manxhari | Cikli i I i studimeve | Kontabilitet –Financë | 0699605117 | manxharieni@gmail.com |
| 7. | Miranda Mamani | Cikli i I i studimeve | Kontabilitet –Financë | 0699967217 | mirandamamani98@gmail.com |
| 8. | Rigels Peçi | Cikli i I i studimeve | Turizem | 0683999038 | pecirigels@gmail.com |
| 9. | Benardo Kokona | Cikli i I i studimeve | Arsim Fillor | 0698598426 | benardokokona@yahoo.com |
| 10. | Elena Kushe | Cikli i II i studimeve | Histori Gjeografi | 0684889556 | elenakushe05@gmail.com |
| 11. | Kristjan Peta | Cikli i I i studimeve | Infermieri e pergjithshme | 0698878763 | kristjan.peta@yahoo.com |
| 12. | Mario Llaka | Cikli i I i studimeve | Fizike –Tekn Informacioni | 0675424253 | albsickn@gmail.com |
| 13. | Vangjel Shumeli | Cikli i II i studimeve | Administrim Publik | 0698718935 | albania4ever93@hotmail.com |
| 14. | Ledia Fili | Cikli i II i studimeve | Kontabilitet Finance | 0676501470 | |
| 15. | Maria Lino | Cikli i II i studimeve | Gjuhe Angleze | 0695160799 | getinformation98@gmail.com |
| 16. | Sidorela Elmazi | Cikli i II i studimeve | Administrim Publik | 0683235309 | sidorelaelmazi96@gmail.com |
| 17. | Mirushe Shuti | Cikli i II i studimeve | Turizem | 0695196718 | mira.shuti@gmail.com |
| 18. | Elena Biraçi | Cikli i II i studimeve | Kontabilitet Finance | 0695139578 | elenabiraci97@gmail..com |
| 19. | Esma Xhebra | Cikli i I i studimeve | Kontabilitet Finance | 0698105403 | esmaxhebra@gmail.com |
| 20. | Grasiela Male | Cikli i I i studimeve | Matematike Informatike | 0683282183 | grasielamale@hotmail.com |
| 21. | Dixhona Burnaci | Cikli i I i studimeve | Turizem | 0676664973 | dixhonaburneci@gmail.com |
| 22. | Rinulla Bashio | Cikli i I i studimeve | Gjuhe Letersi Greke | 0676872072 | rinulabashio@gmail.com |
| 23. | Neandrit Deçka | Cikli i II i studimeve | Histori Gjeografi | 0674748829 | neandrit@gmail.com |
| 24. | Rafaela Nela | Cikli i I i studimeve | Biologji Kimi | 0693051803 | rafaelanela2@gmail.com |
| 25. | Eva Late | Cikli i I i studimeve | Kontabilitet Finance | 0699188475 | evalate1@gmail.com |
| 26. | Armand Muka | Cikli i I i studimeve | Arsim Fillor | 0686179941 | armandmuka@icloud.com |
| 27. | Anjeza Mustafai | Cikli i I i studimeve | Gjuhe Letersi | 0693195838 | anjezamustafaj@hotmail.it |
| 28. | Mevlan Buzi | Cikli i I i studimeve | Biologji Kimi | 0695454815 | buzimevlan8@gmail.com |
| 29. | Alisa Këllçi | Cikli i II i studimeve | Kontabilitet Finance | 0684957037 | alisakellci@gmail.com |
| 30. | Haki Xheko | Cikli i I i studimeve | Administrim Publik | 0684029560 | hxheko@gmail.com |

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" - GJIROKASTËR

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 31. | Denisa Saraçi | Cikli i II i studimeve | Administrim Publik | 0698668317 | denisasaraci09@gmail.com |
| 32. | Mediana Lazaj | Cikli i I i studimeve | Kontabilitet Finance | 0697503397 | medianalazaj@gmail.com |
| 33. | Pamela Sherifi | Cikli i II i studimeve | Kontabilitet Finance | 0693316764 | pamelasherifi@yahoo.com |
| 34. | Paola Deraj | Cikli i II i studimeve | Kontabilitet Finance | 0699386316 | paoladeraj@yahoo.com |
| 35. | Pandeli Prango | Cikli i II i studimeve | Kontabilitet Financë | 0695298955 | prangospandelis@gmail.com |
| 36. | Kavjol Kotroçi | Cikli i I i studimeve | Turizem | 0697324944 | kavjolkotroci@gmail.com |
| 37. | Kristina Kadena | Cikli i I i studimeve | Kontabilitet Finance | 0698287035 | kristinakadena@gmail.com |
| 38. | Kritjon Peci | Cikli i I i studimeve | Informatike | 0698287035 | kritjonpeci@gmail.com |

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" - GJIROKASTËR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ascal
AGJENÇIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

Studentët vlerësojnë

# SONDAZHI
## KOMBËTAR I STUDENTËVE
## 2019

Broshurë informuese



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" - GJIROKASTËR

## I. SONDAZHI KOMBËTAR I STUDENTËVE

Një nga mekanizmat kryesorë të sigurimit të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë në vendin tonë, është matja e kënaqshmërisë së studentëve nëpërmjet Sondazhit Kombëtar të Studentëve (SKS). Kjo metodë përdoret për të nxjerrë informacione të nevojshme për funksionimin e arsimit të lartë në tërësi apo të veprimtarive akademike **në universitete, kolegje universitare, akademi dhe kolegje profesionale të larta**

SKS është proces i cili ka në qendër studentin dhe ka si qëllim kryesor vlerësimin dhe matjen e cilësisë në arsimin e lartë duke vlerësuar performancën e Institucioneve të Arsimit të Lartë në veprimtaritë e mësimdhënies, mësimnxënies dhe kompetencave dhe mbështetjes ndaj studentëve.

Të dhënat e nxjerra nga ky Sondazh do të shërbejnë për marrjen e vendimeve të rëndësishme në hartimin e politikave shtetërore në fushën e Arsimit të Lartë dhe kërkimit shkencor me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë në Arsimin e Lartë.

Sondazhi organizohet dhe monitorohet nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) në bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë (universitetet, kolegjet universitare, akademitë, kolegjet profesionale të larta) dhe Qeveritë Studentore/Këshillat Studentorë.

### SKS është i rëndësishëm sepse:

- Jep informacione reale e të besueshme për cilësinë e Arsimit të Lartë, bazuar tek mendimi dhe opinioni i studentëve.
- Ndihmon vetë *universitetet, kolegjet universitare, akademitë* dhe *kolegjet profesionale të larta* në përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së tyre.
- I jep informacionet e nevojshme drejtuesve/titullarëve të *universiteteve, kolegjeve universitare, akademive* dhe *kolegjeve profesionale të larta*, për hartimin e politikave të zhvillimit të institucioneve, bazuar në nevojat dhe kërkesat e studentëve.
- Informon studentët aktualë, për cilësinë e Arsimit të Lartë në *universitetet, kolegjet universitare, akademitë* dhe *kolegjet profesionale të larta* ku ata studiojnë.
- Informon studentët e rinj për cilësinë e mësimdhënies në *universitetet, kolegjet universitare, akademitë* dhe *kolegjet profesionale të larta* ku ata dëshirojnë të ndjekin studimet e tyre.
- Informon publikun në tërësi, për cilësinë e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë.

## II. PËRMBAJTJA E SONDAZHIT KOMBËTAR TË STUDENTËVE

Vlerësimi nëpërmjet SKS bazohet në një pyetësor, plotësimi i të cilit nuk zgjat më shumë se **20 minuta**. Duke i'u përgjigjur pyetjeve, studentët do të japin mendimin për 6 (gjashtë) kategoritë e mëposhtme:

### 1. Organizimi i institucionit, menaxhimi dhe funksionimi i tij

Institucionet e arsimit të lartë në vendin tonë, organizohen në **njësi kryesore** që janë: *fakultetet, institutet kërkimore-shkencore;* **njësi bazë,** që janë: *departamentet, qëndrat kërkimore-shkencore* të cilat funksionojnë brenda një fakulteti apo instituti kërkimor-shkencor; si dhe në njësi të tjera siç janë *laboratoret, bibliotekat, sallat e informatikës,* etj., që quhen **njësi ndihmës-akademike** dhe *sekretaritë mësimore, zyrat e ndryshme,* që quhen **njësi administrative.**

Pyetjet në këtë kategori janë mbi informacionet që studenti ka për organizimin ose e thënë ndryshe, strukturën e *universitetit, kolegjit universitar, akademisë apo kolegjit profesional të lartë,* ku ndjek studimet dhe mendimi i tij në lidhje me këtë strukturë.

Ka pyetje për studentët në lidhje me informacionin që ata kanë për drejtimin e institucionit ku ata ndjekin studimet, për interesin dhe mbështetjen e vazhdueshme të rektorit/dekanit/përgjegjësave të departamenteve dhe drejtuesve të tjerë ndaj nevojave të studentëve.

Përfshihen dhe pyetje që kanë të bëjnë me informacionin që kanë studentët për bashkëpunimin me institucione të tjera me qëllim kryerjen e praktikave profesionale apo mundësitë e mobilitetit (psh. *programet ERASMUS*).

Studentët gjithashtu do të kenë mundësi të japin mendimin që ata kanë mbi marrjen e vendimeve brenda Institucioneve ku janë duke ndjekur studimet, mbi dokumentet kryesore të institucionit, si dhe të japin mendimin e tyre për publikimin e vendimeve që merren.

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTER

## 2.Burimet

Me pyetjet e kësaj kategorie trajtohet informacioni që kanë studentët për burimet në funksion të mësimdhënies.

Këto përfshijnë burime si: **infrastruktura fizike** (*salla leksioni, seminari, ambjente sportive, ambjente çlodhëse,* etj.); **infrastruktura didaktike** *(laboratorë, biblioteka, internet, etj.)*; **stafi akademik** *(komunikimi dhe mbështetja nga pedagogët,* etj.); **mundësitë fizike dhe financiare** që jep Institucioni për aktivitete të ndryshme studentore (psh. *për mbledhjet e Qeverisë/Këshillit Studentor, aktivitete sociale, kulturore, sportive,* etj.)

## 3. Kurrikulat, përmbajtja dhe përditësimi

Kjo kategori përmban pyetje për informacionin që studenti ka për përmbajtjen e programit të studimit.

Studentët kanë mundësi të përgjigjen për njohuritë që ata kanë se çfarë lëndësh zhvillohen në programin e studimit që janë duke ndjekur, si është e organizuar secila lëndë në leksione, seminare, praktikë, detyra kursi, mënyra e vlerësimit, provimet, temat që trajtohen në çdo orë leksioni, tekstet që ju nevojiten për studim, leksionet që ju jepen nga pedagogët, literatura ndihmëse, seminaret, etj.

## 4. Mësimdhënia, mësimnxënia, vlerësimi

Në këtë kategori studentët do të kenë mundësi që veç përgjigjeve mbi informacionet që ata kanë, të japin dhe mendimin dhe vlerësimin e tyre mbi trupën pedagogjike, psh. për aftësitë e tyre në shpjegimin e njohurive, koncepteve dhe metodave që përdorin gjatë leksioneve të ndryshme.

Studentët do të pyeten dhe për materialet që ju vihen në dispozicion nga pedagogët si dhe transparenca, paanësia në vlerësimin e tyre për detyrat e ndryshme, esetë, provimet e ndërmjetme, dhe vlerësimin final të lëndës.

## 5. Aktiviteti kërkimor, projekte, studime, botime

Në këtë kategori studentët japin mendime dhe vlerësime mbi mbështetjen nga institucioni për zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kërkimore-shkencore apo nxitjen dhe mbështetjen e ideve të reja.

Kjo do të thotë nëse institucioni ju mundëson financime apo iu vë në dispozicion bazë materiale si laboratore, kompjutera, tekste të ndryshme, etj. Nëse pedagogët tuaj ju përfshijnë dhe ju mbështesin të aktivizoheni në botime, në kërkim shkencor, në pjesëmarrje ose organizimin e konferencave studentore apo në mobilitete (psh. programet Erasmus) që lidhen me programin tuaj të studimit.

## 6. Studentët dhe mbështetja e tyre

Në këtë kategori studentët japin mendime dhe vlerësime për informacionin që kanë para regjistrimit në Institucion, mbështetjen që japin zyrat e ndryshme administrative gjatë kryerjes së studimeve, lehtësirat financiare që mund të përfitojnë si dhe rastet dhe mënyrat e përfitimit të tyre.

Studentët gjithashtu mund të vlerësojnë masat konkrete dhe përpjekjet që bën Institucioni për të mundësuar lidhjen e tyre me tregun e punës dhe ofertat e punësimit.

*Të njëjtat kategori dhe pyetje do të përdoren për të gjitha institucionet që do t'i nënshtrohen vlerësimit të mësimdhënies pavarësisht nga madhësia, historiku apo statusi i tyre.*

## III. ZHVILLIMI I SONDAZHIT KOMBËTAR TË STUDENTËVE

**Është e rëndësishme që pjesëmarrja në SKS të jetë maksimale, në mënyrë që çdo student të shprehë mendimin e vet për Institucionin ku ka zgjedhur të studiojë.**

Meqënëse SKS është një proces i cili bazohet mbi mendime dhe opinione të studentëve për Institucionet ku ata janë pjesë dhe studiojnë, është gjithashtu e rëndësishme që studenti të kete njohuri për Institucionin e vet dhe të japë mendimin e tij të pavarur dhe të pandikuar nga rrethanat apo opinionet e tjera.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR

tësori zhvillohet online nëpërmjet platformës që është
jatitur për këtë qëllim.
ë fazës së plotësimit të pyetësorëve, Institucionet vënë në
ozicion të studentëve, salla dhe laboratorë informatike.
dentët do të njoftohen nëpërmjet email për fillimin dhe
un e plotësimit të pyetësorit. Studentët kanë mundësi
lotësojnë atë në çdo kohë nga çdo ambjent, si nga
ratet e ndryshme celular dhe nga sallat e kompjuterave
ëna në dispozicion nga Institucioni. Në këto raste,
esi do të monitorohet nga ASCAL dhe në sallë gjatë
it të caktuar, nuk do të ketë asnjë përfaqësues nga
agogët apo stafi tjetër i Institucionit.

hillat Studentor apo Qeveritë Studentore kanë një rol të
dësishëm për informimin e studentëve për rëndësinë e
esit, për përgjegjësinë ndaj institucionit për të dhënë
gjigje të sakta dhe reale, për afatet e plotësimit si dhe
rmimin me rezultatet përfundimtare. Për çdo informa-
Këshillat Studentor/Qeveritë Studentore, duhet t'i
tohen Koordinatorit Institucional i cili është person
takti për ta.

disa nga pyetjet e SKS, studenti përgjigjet me **po/jo/-
e di**. Ka dhe pyetje ku si përgjigje mund të zgjedhë më
më se një alternativë, si dhe në disa pyetje është lënë
ndësia për dhënien e një teksti të shkurtër përshkrimor.

përgjithësi pyetjet janë të organizuara në mënyrë të tillë
studenti të japë mendim ose vlerësim të klasifikuar në 5
ale duke filluar nga vlerësimi *minimal/keq* në *maksi-
l/shumë mirë*, ose *nuk pranoj/nuk miratoj/nuk jam
ord* në jam *plotësisht dakord*, etj.

**Konkretisht:**

*Vlerësimi 1 – keq / aspak dakord*

*Vlerësimi 2 – jo mirë / fare pak dakord*

*Vlerësimi 3 – mirë / pjesërisht/ as pro as kundër*

*Vlerësimi 4 – mjaftueshëm / kryesisht dakord*

*Vlerësimi 5 – shumë mirë / plotësisht dakord*

## IV. TRANSPARENCA, ANONIMATI DHE KONFIDENCIALITETI

- Procesi i plotësimit të pyetësorit është **anonim** dhe bazohet tërësisht në **opinionin individual të studentëve** për Institucionin ku ata studiojnë.
- Përpara plotësimit të pyetësorit, çdo student ka të drejtë të jetë i mirëinformuar në lidhje me këtë Sondazh, mënyrën e organizimit të tij dhe qëllimin për të cilin ai realizohet.
- SKS do të ofrohet në **dy gjuhë (shqip dhe anglisht)** për t'u dhënë mundësi plotësimi studentëve vendas dhe të huaj.
- Pyetësori kërkon të mbledhë mendimin e studentit për Institucionin. Përgjigjet janë individuale dhe anonime.
- Të dhënat për studentët (emri dhe e-mail) sigurohen zyrtarisht nga institucionet e arsimit të lartë ku studentët ndjekin studimet. Emri dhe e-mail i çdo studenti përdoren vetëm për dërgimin e pyetësorit në llogarinë e tij (link-u për akses të pyetësorit dhe kodi për akses).
- Analiza e përgjigjeve kryhet në mënyrë statistikore. Në asnjë rast nuk identifikohet përgjigja me emrin e individit. Çdo individi i merret mendimi vetëm njëherë në një pyetësor të caktuar.
- Informacionet e mbledhura trajtohen në përputhje me legjislacionin shqiptar të arsimit të lartë dhe ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

## V. REZULTATET DHE RAPORTI PËRFUNDIMTAR

Realizimi i SKS është detyrim ligjor në kuadër të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë dhe për këtë arsye marrin pjesë të gjithë studentët nga të gjitha *universitetet, kolegjet universitare, akademitë dhe kolegjet profesionale të larta* që operojnë në Republikën e Shqipërisë apo filiale të institucioneve të huaja të licencuara në vendin tonë.

Në përfundim të procesit hartohet raporti analitik me re
tatet e pyet[...]uar me analizat përkatëse
institucio[...]e ndryshme [...]u përgjigjur interesit pu
apo te[...]likë[...]ës.

Ky ra[...]t pub[...] në faqe[...] zyrare të Agjencisë
Sigurim[...]e Cilësisë në Arsim[...]e Lartë (ASCAL), i dë
het insti[...]neve përka[...]si dhe Ministrisë së Arsi
Sportit dhe [...]

## VI. PËRMBYLLËSE

Studentët gjatë gjithë procesit kanë asistencën e nevojshme
sqarime, informacione dhe suport teknik nga Grupi i Punës,
i ASCAL dhe Koordinatori i Institucionit. Në dispozicior
studentëve vihet ky udhëzues, informacione dhe portali or
për sqarimet e duhura.

Institucionet duhet të jenë të ndërgjegjshme në lidhje
rëndësinë që ka aktivizimi i studentëve si dhe nevojën
përfaqësimin e gjerë të tyre. Ato krijojnë dhe ofrojnë të g
lehtësirat e duhura për studentët për plotësimin e SKS
ambjente të posaçme, nëse është e nevojshme.

ascal

Rr. e Durrësit, nr. 219, Tiranë
Phone: +355 4 222 43423
E-mail: info@ascal.al
Web: www.ascal.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR